




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS SHKODËR

Nr. 14/5 Prot.

Shkodër, më 28/02 /2022

LËNDA: Kërkesë për shpallje publike



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT

DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE

Adresa: Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1,
Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë", 4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ..." kërkojmë shpalljen publike për;


- **Vendimin Administrativ nr. 08 datë 19.01.2022** për subjektin "ADELCHI SHQIPËRI" SHPK, me NIPT K06424016C, me administrator z. Paulin Radovani, me adresë: Lagjia "Tre Heronjtë", Rruga "Pal Engjëlli", Zona Kadastrale 8593, nr.pasurie 10/76, Shkodër.

Për vazhdimin e procedurave ligjore për rikuperimin e borxhit doganor është domosdoshmëri data e shpalljes publike.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

KRYETAR

Aida DIZDARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
Dega e Doganës Shkodër

Nr. 14/ Prot.
2

Shkodër, më 13/01/2022

V E N D I M
Nr.08, datë 19.01.2022

Autoriteti vendimmarrës i Degës Doganës Shkodër, mori në shqyrtim, procesverbalin e datës 12.11.2021 protokolluar me nr.2728 datë 12.11.2021 të mbajtur nga grupi i punës, pranë Degës së Doganës Shkodër, lidhur me konstatimet e bëra për subjektin **“ADELCHI SHQIPËRI” SHPK, me NIPT K06424016C, me administrator z. Paulin Radovani**, me adresë: Lagjja “Tre Heronjtë”, Rruga “Pal Engjëlli”, Zona Kadastrale 8593, nr.pasurie 10/76, Shkodër.

Pasi u shqyrtua procesverbali i mësipërm dhe dokumentacioni bashkëlidhur, rezulton se: Subjekti **“ADELCHI SHQIPËRI” SHPK, me NIPT K06424016C**, ka punuar nën “Regjimin e Përpunimit Aktiv” me autorizimin nr. 25058/2 prot., datë 16.10.2019 të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe gjatë punës nën këtë autorizim, subjekti ka kryer disa import/eksporte, ku sasisë së mallit të importuar i ka dhënë një destinacion doganor në sasi e në vlerë, por pjesës së mbeturinave (nga procesi teknologjik) nuk i ka dhënë akoma një destinacion doganor.

Në analizim të këtij autorizimi, rezulton se subjekti ka marrë disa shtesa për pika të ndryshme të autorizimit, konkretisht shtesën me nr.1569/1 prot., datë 03.08.2020.

Sipas pikës 3/c të këtij autorizimi, si dhe shtesës së marrë për sasi e vlerë, sasia e autorizuar është 460.000 palë faqe këpucësh dhe 460.000 shtroje këpucësh, ndërsa sipas pikës 3/d vlera e vlerësuar është 6.400.000 euro.

Sipas pikës 13 të autorizimit me nr. 25058/2 prot., datë 16.10.2019, afati i rieksporimit është 12 muaj, pra subjekti ka mundur të bëjë veprime me këtë autorizim deri me datë 17.10.2020.

Ndodhur në kushtet ku subjekti nuk mund të bëjë asnjë veprim u analizua autorizimi në tërë pikat e tij dhe nga rakordimet e bëra nga subjekti, si dhe verifikimit nga sistemi, vërehet se me autorizimin nr. 25058/2 prot., datë 16.10.2019 subjekti ka kryer këto lëvizje (*sipas tabelës 1*).

Tabela 1

Procedura	Faqe (copë)	Shtroje (copë)	Vlera (euro)	Pesha
Importe	237.057	34.525	1.654.330	94.321,9
Exporte	237.057	34.525	1.654.330	85.466
Import 9				6.940
Gjendja përfundimtare	0	0	0	1.915,3 (kg)

Si rrjedhim, subjekti tërë mallin e importuar në sasi e vlerë e ka rieksportuar. Sasisë prej 1.915,3 kg me vlerë 0 (mbeturinë), nuk i ka dhënë akoma një destinacion doganor. Pra, kjo sasi e mbeturinave bashkë me atë të zhdoganuar me Imp.9, përbën 10% të mallit të importuar, gjë që

përputhet me skedat teknike dhe me koeficientin e shfrytëzimit të materialeve që përdoren për prodhimin e faqeve të këpucëve.

Sa më sipër, subjekti në kundërshtim me pikën i, të nenit 251, të Kodit Doganor, nuk ka sjellë dokumentin e mbylljes së regjimit, dhe në kundërshtim me germën c, të nenit 252 të Kodit Doganor, nuk i ka dhënë destinacion mallrave nën mbikëqyrjen doganore.

Në zbatim të pikës 4, të nenit 273 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe neneve 47, e vijues të Kodit të Procedurës Administrative, dega doganore me shkresën nr. 2728/1 prot., datë 12.11.2021, ka njoftuar subjektin për procesverbalin nr. 2728, të mbajtur nga grupi i punës pranë degës, sipas lajmërim marrjes RR 652 920 500 AA, për të cilën subjekti nuk ka marrë dijëni pasi zarfi është kthyer me mbishkrimin “objekt i pa kërkuar” me datë 07.12.2021.

Referuar shkresës nr.2344/5 prot., datë 31.12.2020, lënda “Kërkesë për sqarim” Dega Doganës Shkodër i është drejtuar Filialit të Postës Shkodër, duke kërkuar informacion sqarues për shënimin “Objekt i pa kërkuar” në rastin që është kthyer zarfi dhe se si duhet të vepohet në rastet kur informacioni për adresën është ai që disponojmë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Me shkresën nr.51 prot., datë 13.01.2021, lënda “Kthim Përgjigje” protokolluar pranë Degës së Doganës Shkodër me nr.95 prot., datë 15.01.2021, Filiali i Postës Shkodër na sqaron se ***“Objekt i pa kërkuar” do të thotë, kur postieri nuk e dorëzon dot objektin, lë lajmërim me shkrim të kompania dhe personi marrës nuk vjen të tërheqë objektin, pra nuk e kërkon objektin postar.***

Ndodhur në këto kushte, për një procedurë sa më të rregullt ligjore, me shkresën nr.14 prot., datë 06.01.2022 në zbatim të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”, u shpall për njoftim publik, pranë këndit të njoftimeve në Degën e Doganës Shkodër, i cili qëndroi i afishuar që nga data 06.01.2022 deri më 15.01.2022. Në zbatim të pikave 1 dhe 2 të këtij neni, njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Ndërsa me shkresën nr. 14/1 prot., datë 06.01.2022 është bërë kërkesë për shpallje publike pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për procesverbalin nr.2728 prot., datë 12.11.2021, për të cilën QKB ka konfirmuar shpalljen publike në faqen e saj zyrtare <https://qkb.gov.al/shpallje/njoftime-nga-organet-doganore/> me shkresën Nr. 634 prot., datë 10.01.2022 të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (sipas vulës protokollare), e cila është edhe data e shpalljes së procesverbalit.

Përsa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër gjen të drejtë zbatimin e germës “i”, të nenit 251, germës “b”, pikës 1, të nenit 256, germës “c”, të nenit 252, germës “b”, të nenit 257 të Ligjit Nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe;

V E N D O S I:

1. **Shpalljen debitor të subjektit “ADELCHI SHQIPËRI” SHPK, me NIPT K06424016C,** për shkeljet e konstatuara nën autorizimin e RPA-së nr. 22732/1, datë 18.10.2018 si më

poshtë vijon;

- Për mos paraqitjen e dokumentit të mbylljes së regjimit të RPA-së nr. 25058/2 prot., datë 16.10.2019, në kundërshtim me pikën (i), të nenit 251 dhe aplikimin e sanksioneve bazuar në germën (b), pika 1, të nenit 256 të Kodit Doganor, **në shumën 20.000 (njëzetëmijë) lekë.**
- Për mos dhënien destinacion doganor të mallrave nën RPA, në kundërshtim me germën (c), të nenit 252 dhe aplikimin e sanksioneve bazuar në germën (b) të nenit 257 të Kodit Doganor **në shumën 30.000 (tridhjetëmijë) lekë.**

Në total, në shumën prej 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë.

2. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Zyrës së Financës për kontabilizim.
3. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore për pasqyrimin e këtij vendimi në sistem.
4. Bazuar në nenin 281 dhe 282 e Kodit Doganor, kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankm tek Drejtori i Përgjithshëm i Doganave brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim.

KRYETARI

Aida DIZDARI



Koncept: A.Dibra